

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

Health & Light

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L42231011L

NUIS/NIPT

Rruga Themistokli Germenji, Nd. 11, H. 4, Ap. 4, Njesia Administrative Nr. 2, 1010, Tirane

Adresa

Tiranë

Albania

1027

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0672024431

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

042229850

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@healthlight-al.com

E-mail

Administrator Ridi Cipo

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/10/19

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0672024431

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-83327-10-11-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Spitali Universitar i Traumes

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

25133333

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

? LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë.

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/11/13

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/11/13

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-83327-10-11-2023

33100000-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 Per Prokurimin Publik, Neni 36 - Specifikimet teknike, Neni 21 - Autoriteti ose enti kontraktor

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Jemi informuar nepermjet Sistemit Elektronik te Prokurimit Publik, per publikimin e procedures se prokurimit me objekt: “Blerje pajisje dhe aparatura mjekësore për SUT”e ndare në lote, gjithsej 6 Lote. Pasi studiuam me vemendje specifikimet teknike dhe kerkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor ne kete procedure prokurimi, vume re qe specifikimet teknike te kerkuara jane hartuar ne kundërshtim me Ligjin 162/2020 Per Prokurimin Publik, duke anashkaluar kriterin e trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Me poshte po parashtojme argumentet dhe kerkesat tona.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Loti 1 - Blerje sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë
Gjatë hartimit të specifikimeve teknike të harkut C janë vendosur specifikime që nuk i përkasin teknologjisë me panel të sheshtë nga njëra anë dhe nga ana tjetër ka specifikime të cilat orientojnë drejt një prodhuesi të vetëm. Sa më poshtë vijon, më specifikisht po ju paraqesim argumentet tona :

Argumenti 1

Specifikimi : Fluoroskopi e vazhdueshme mA: = 15 mA

Sqarim : Fluoroskopia e vazhdueshme ka qenë tipike për sistemet me intensifikator imazhi. Në ditët e sotme përdoren detektorët e sheshtë të cilët nuk mund të punojnë me fluoroskopi të vazhdueshme. Kjo për faktin që detektori nuk lexon/mbledh informacion gjatë gjithë kohës. Detektori merr informacionin dhe më pas e lexon atë dhe pastaj e fshin dhe rrjedhimisht nuk merr informacion të vazhdueshëm. Kështu fluoroscopia e vazhdueshme nuk është e aplikueshme më.

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të hiqet sepse nuk është pjesë logjike e specifikimeve të një harku C me detektor të sheshtë. dhe të zëvendësohet me fluoroskopi pulsuese.

Argumenti 2

Specifikimi : Fluoroskopi e vazhdueshme = 30 f/s

Sqarim : I njëjti arsyetim vlen njësoj si për pikën e mësipërme. Duhet të jetë fluoroskopi pulsuese. Nga an tjetër kërkohet të ketë 30 frame për sekondë. Ky parametër dihet që është tipik për ekzaminime kardiake ku kemi lëvizje të shpejta anatomike, dhe jo për ekzaminime vasculare apo për ortopedinë. për të cilat është më se e mjaftueshme që të kenë një numër më të ulët.

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të hiqet sepse nuk është pjesë logjike e specifikimeve të një harku C me detektor të sheshtë dhe të zëvendësohet me fluoroskopi pulsuese 15 f/s

Argumenti 3

Specifikimi : Rezolucion në monitor gjatë grafisë = 3.0 lp/mm në të tëra fushat aktive

Sqarim : Prodhesit kanë përjasje të ndryshme teknologjike në lidhje me cilësinë e mirë të imazhit me qëllim që të arrijnë trajtime të mira dhe rezultate të mira diagnostike.

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në = 2,5 lp/mm pa zmadhim dhe = 3.0 lp/mm në të gjithë fushat e tjera aktive.

Argumenti 4

Specifikimi : Rezolucion në monitor gjatë fluoroskopisë = 3.0 lp/mm në të tëra fushat aktive

Sqarim : Prodhuesit kanë përjasje të ndryshme teknologjike në lidhje me cilësinë e mirë të imazhit me qëllim që të arrijnë trajtime të mira dhe rezultate të mira diagnostike.

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në = 2,5 lp/mm pa zmadhim dhe = 3.0 lp/mm në të gjithë fushat e tjera aktive.

Argumenti 5

Specifikimi : Ndërfaqja Audio (Aux In) dhe sistem të integruar të zërit me altoparlant dhe ndërfaqe
Sqarim : Ky është një specifikim tipik i Siemens ku thuhet : SOUND SYSTEM : INTEGRATED EMTORION SOUND SYSTEM WITH INTERFACE FOR CONNECTING EXTERNAL (mp3) AUDIO EQUIPMENT VIA AUX IN JACK INCLUDING AMPLIFIER WITH DIGITAL SOUND PROCESSOR..... Këtë specifikim e ka vetëm Siemens dhe rrjedhimisht të gjithë prodhuesit e tjerë skualifikohen

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të hiqet

Argumenti 6

Specifikimi : Optimizim digital i dendësisë

Sqarim : Edhe ky është një specifikim tipik që përdoret te Siemens me termin DDO (Digital Density Optimization) .

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në Rregullim automatik dhe manual i kontrastit dhe ndriçimit

Argumenti 7

Specifikimi : Përcaktim i vlerave gjeometrike dhe te dendësisë.

Sqarim : Edhe ky është një specifikim tipik që përdoret te Siemens me termin Stenosis quantification* Quantification program for geometric and densitometric values

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të hiqet

Argumenti 8

Specifikimi : Përcaktim i vlerave gjeometrike dhe te dendësisë.

Sqarim : Edhe ky është një specifikim tipik që përdoret te Siemens me termin Stenosis quantification* Quantification program for geometric and densitometric values

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të hiqet

Argumenti 9

Specifikimi : Pjerrësim = (? 220 ?)

Sqarim : Edhe ky është një specifikim tipik i Siemens

Kërkesë : Kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet në = (? 200 ?) i cili nuk ka impakt domethënës klinik

Argumenti 10

Specifikimi : Këndi i shikimit horizontal / vertikal 178 ? / 178 ?

Sqarim : Ky është një specifikim thjesht për të larguar konkurrencën dhe është tipik për Siemens

Kërkesë : Propozojmë që të bëhet 170 ?/170? dhe që të ketë mundësi që të bëjë edhe lëvizje vertikale prej min 18 cm.

Argumenti 11

Specifikimi : Memorie HDD = 2 TB

Sqarim : Hard disku i pajisjes nuk mendohet që të jetë edhe njësi arkivimi. Arkivimi në vetvete bëhet në PACS dhe nuk ka nevojë që të jetë në Hard Disk.

Kërkesë : Kërkojmë që të bëhet 1 TB

Argumenti 12

Specifikimi : WLAN /WiFi 150 Mbit/s IEEE 802.11 a, b, e, g, h, i, n IEEE 802.11 a/b/g/n/ac (2.4 GHz and 5 GHz band)

Sqarim : Janë specifikime për produkt të caktuar të kompanisë prodhuese Siemens

Kërkesë : Propozojmë që të bëhet në
IEEE 802.11 a/b/g/n/ac (2.4 GHz and 5 GHz band): ĒPA and ĒPA2, 802.1X (EAP-TLS, PEAP)

Argumenti 13

Kërkojmë që të hiqen specifikimet e mëposhtme të cilat në vetvete ngushtojnë konkurrencën.

- Ndërfaqe për injektor kontrasti për lidhjen e një injektor kontrasti
- Kërkesë automatike për injektim kontrasti pas marrjes së imazhit

Mjeku injekton kontrastin dhe pastaj fillon normalisht punën.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

S'ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit: 042229850

E-mail: info@healthlight-al.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar Ridi Cipo